

INFORMACIONE PËR REGJISTRIMIN NË SHËRBIMIN PARASHKOLLOR

0-3 VJEÇ VITI SHKOLLOR 2019/2020

KUSH MUND TË REGJISTROHET

Aplikimet *on line* për vitin shkollor 2019-2020 në Shërbimet Edukuese 0-3 vjeç (çerdhe dhe hapësira lojërash), do të nisnin nga fundi i marsit deri në fillim të prillit dhe janë të rezervuar fillimisht fëmijëve të lindur nga 01/01/2017 deri më 31/05/2019, dhe pas një periudhe ndërprerjeje, do të rifillojnë, nga mesi i dytë i muajit maj deri në fillim të qershorit por vetëm për fashën e të vegjëlve. Gjithashtu, familjet e fëmijëve të lindur nga data 01.06.2019 deri më 31.08.2019, mund të prezantojnë kërkesën nga muaji shtator, edhe pse jashtë afatit të aplikimeve, por me kusht që fëmija të ketë mbushur të paktën tre muaj.

Kërkesa për aplikim bëhet nga prindi që është rezident në Komunën e Firences së bashku me fëmijën, dhe ka formën e vetëdeklarimit dhe të deklaratës zëvendësuese të vërtetimit sipas DPR n. 445/2000 dhe ndryshimeve dhe integritimeve pasuese. Në rast kontrolli mos vërtetësia e deklaratës përveç pasojave ligjore, sjell dhe humbjen e çdo të mire që është përfituar deri në atë moment.

Në rast se prindërit janë të ndarë/divorcuar duhet të jetë e bashkangjitur dhe autorizimi i/e prindit tjetër, së bashku me një dokument identifikimi. Në mungesë të autorizimit, kërkesa për regjistrim nuk do të mund të pranohet.

Detyrimet ndaj vaksinave, sipas ligjit 119/2017 dhe ndryshimeve dhe integritimeve pasuese, është një nga kushtet kryesore për regjistrim dhe pranimin në Shërbimin parashkollor 0-3 vjeç.

SI MUND TË REGJISTROHENI

Kërkesa për regjistrim mund të bëhet vetëm *on line* duke u lidhur me faqen e Shërbimeve të Komunës së Firences "Iscrizione nidi d'infanzia/spazi gioco educativi": <http://servizi.055055.it/iscrizioneasilife>

Për aplikim është i nevojshëm, në alternativë, të keni një nga dokumentet e mëposhtëm (të cilat ju mund ti gjeni me kohë):

A) Zarf me Kredencialet (emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi): kush nuk i ka mund ti kërkojë (me një dokument identifikimi të vlefshëm dhe kodin fiskal) pranë Zyrave për Qytetarët (URP) të Komunës së Firences, zyrave të Shërbimeve për parashkollorët- Çerdhet, Rruga Nicolodi n.2 ose, *vetëm për familjet e huaja, pranë Zyrës së Emigracionit*, Lagjia 5- Villa Pallini, Rruga Baracca 150 p;

Gjithashtu, për të kërkuar kredencialet mund të plotësoni formularin *on line* në faqen e internetit: <http://centroservizi.lineacomune.it/ConsoleCittadino/>.

Më pas duhet të paraqiteni pranë zyrave të akredituara me një dokument identifikimi të vlefshëm dhe kodin fiskal për të tërhequr Kredencialet (që do të thotë zarfin e mbyllur me passwordin brënda): <http://centroservizi.lineacomune.it/portal/page/portal/Registrazione/sportelli>

B) Karta e shëndetësisë e qarkut e aktivizuar pranë sporteleve ASL të Rajonit Toskana, ose **Karta Kombtare e Shërbimeve (CNS)**.

Në këto raste, është i domosdoshëm lexuesi *smart card*, i cili mund të blihet pranë Zyrave Shëndetësore që të futeni në shërbimin *On-Line* nga PC-a personal.

C) Fjalëkalimi dhe password të Sistemit Publik për menaxhimin e Identitetit Dixhital (SPID)

KUJDES për Shërbimet *on line* duhet të **përdorni vetëm browser Mozilla Firefox ose Chrome**

Familjet e huaja që janë rezidentë në Firenze dhe kanë vështrësi me gjuhën italiane mund të shkojnë pranë Zyrës së Emigracionit, Laggia 5 – Villa Pallini, Rruga Baracca 150 P, ku ndërmjetësit gjuhësor - kulturorë do ti ofrojnë ndihmën e nevojshme për plotësimin e aplikimit *on line*. Mund të lënë një takim duke telefonuar më parë Zyrën e Emigracionit:

http://politichesocioabitative.comune.fi.it/stranieri/servizi/sportelli_immigrazione.html

Pas mbylljes së regjistrimeve do të formohet dhe publikohet lista e pranimeve në bazë të pikëve të marra sipas kritereve të cilat do të publikohen *on line* para hapjes së regjistrimeve.

SA PAGUHET

Tarifat ndryshojnë në varësi të orarit të frekuentimit të përzgjedhur dhe të ardhurave familjare, gjithnjë nëse është prezantuar kërkesa për lehtësim tarifash *on line* (vetëm në rast se keni çertifikatën e ISEE-së më të ulët se 32.500,00 Euro):

Kërkesa për lehtësim tarifash mund të prezantohet:

Në momentin e aplikimit për regjistrim në Çerdhe /Hapësira lojrash

Ose edhe më vonë nëpërmjet Shërbimit *On Line* të Komunës në zërin “Domanda unica di Agevolazione tariffaria Servizi di Supporto alla Scuola/Asili Nido/Centri estivi”. <http://servizi.comune.fi.it/servizi/servizi-online/istruzione-e-formazione>.

Tek faqja e Komunës “Portale Educazione” është i disponueshëm një **SIMULUES TARIFOR** që ndihmon familjet për të kuptuar sa mund të jetë pagesa:

<https://servizi.055055.it/simulatoreTariffarioFE/>

ËSHTË E DOMOSDOSHME TË KEM ÇERTIFIKATËN E ISEE-së NË MOMENTIN E APLIKIMIT?

E patura e çertifikatës ISEE në momenti e aplikimit *on line* nuk është e domosdoshme. Megjithatë, kjo çertifikatë është e rëndësishme për arsyet në vijim:

1) Kush ka çertifikatë ISEE me vlerë më të ulët se € 32.500,00 mund të prezantojë në momentin e aplikimit edhe kërkesën për lehtësim tarifash.

2) Nëse çertifikata ISEE është më e ulët se € 42.000,00 ju lejon të përfitoni pikë shtuese në renditjen e listës përfundimtare

3) Nëse çertifikata ISEE është më e lartë se € 42.000,00 vlen gjithsesi si kriter preference në rast të pikëve të barabarta me një aplikues tjetër

4) Për të gjithë ato që rezultojnë në listat e pritjes (sepse nuk janë pranuar në çerdhe apo hapësira lojrash) mund të jepen kontribute ekonomike për regjistrimet në strukturat private të akredituara. Për të përfituar nga këto kontribute do të jetë e detyrueshme që të tregohet vlera e ISEE-së sipas mënyrës dhe kohës që do të publikohet më vonë në njoftimin e kontributit ekonomik.

CILAT DHE SA STRUKTURA MUND TË ZGJIDHEN?

Mund të zgjidhen **maksimumi deri në 5 struktura** sipas një renditjeje përparësie. Disa struktura pranojnë vetëm fëmijë me moshë të mesme dhe të madhe, apo vetëm të madhe; për këtë arsye do të jetë e mundur të zgjidhni vetëm ato struktura që janë të përshtatshme me moshën e fëmijës. Për çdo strukturë, aplikuesi duhet të zgjedhë orarin e hyrjes dhe të daljes, sipas atyre të parashikuara nga vetë struktura arsimore.

Me hapjen e regjistrimeve, do të caktohen dhe ditët kur familjet mund të vizitojnë ambientet arsimore.

Lista e shërbimeve komunalë të ndara sipas lagjeve:

http://educazione.comune.fi.it/0-3anni/sistema_servizi/servizi_comunali.html

Strukturat private të akredituara:

http://educazione.comune.fi.it/0-3anni/sistema_servizi/servizi_accreditati_authorized.html

Karta e shërbimeve:

http://educazione.comune.fi.it/0-3anni/sistema_servizi/carta_servizi.html